

Periudha naziste në shtetet baltike

Michael Zimmermann

Tipari dikotomik i persekutimit | Njësitë mobile vrasëse | Letonia | Estonia | Auschwitz-Birkenau

➤ Në shtetet baltike vrasja e romëve filloi menjëherë pas sulmit gjerman në vitin 1941. SS dhe ushtria gjermane vranë romët që iu binin në dorën e tyre. Më vonë, kur forcat mobile u transformuan në njësi statike dhe u plotësuan me njësi policore, ata vazhduan me përkrahje prej autoriteteve pushtuese civile. Në Estoni vetëm 5 deri 10 përqind e popullatës rome të para luftës i mbijetuan okupimit gjerman.

PARATHËNIE

Sulmi gjerman në Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet Baltike në verë të vitit 1941 që nga fillimi kishte karakterin e luftës raciste të okupimit dhe asgjësimit. Për këtë fushatë katër task forca u krijuan (“Einsatzgruppen”) – njësitë vrasëse mobile të SS (“Schutzstaffel”, skuadrilja mbrojtëse). “Einsatzgruppen” së bashku me njësitë tjera SS, ushtrinë gjermane dhe forcat pushtuese civile vranë romët që iu binin në duar, por nuk i kërkonin ata me zellin që kishin për zbulimin e Çifutëve dhe komunistëve. Mirëpo, kur “Einsatzgruppen” u transformuan në njësi fikse lokale të Policisë së Sigurisë (“Sicherheitspolizei”) dhe të plotësuara nga njësitë e Policisë Gjermane të Rendit (“Ordnungspolizei”), sikurse në regjionin e Baltikut, ata vazhduan me vrasjen sistematike të romëve. Nga viti 1941 deri në vitin 1943, në Letoni me gjasë gjysma e 3,800 romëve u masakruan. Në Estoni më shumë se 90 përqind të

BASHKIMI SOVJETIK I PUSHTUAR VJESHTË 1942

III. 1 (bazuar në Kenrick / Puxon 1995, f. 88 dhe Zimmermann 1999, f. 141)

1 REICHSKOMMISSARIAT OSTLAND

GENERAL-GOUVERNEMENT

2 REICHSKOMMISSARIAT UKRAINE

750-850 romëve u vranë. Rasti i Lituanisë kërkon më shumë hetim, por historianët vlerësojnë se u vranë shumica e popullatës rome që jetonte aty. Përveç kësaj, në fillim të vitit 1944, 2,000-3,000 romë u dëbuan në Auschwitz Birkenau nga Bjellorusia dhe Lituania.

..... Vija e fronti, Vjeshtë 1942
➡ Itinerari i Einsatzgruppen A, B, C, D

1 2 Nën sundimin civil gjerman
3 Nën sundimin ushtarak gjerman

3 TERRITORET USHTARAKE

DETI I ZI

TIPARI DIKOTOMIK I PERSEKUTIMIT

Persekutimi nacional socialist i romëve varej në konceptin se sjellja e grupeve sociale ishte rrënjësuar në parametrat biologjik dhe faktorët gjene-

tik. Në aspektin e romëve, ky nocion racor kishte dy tipare karakteristike: shënjestra primare e persekutimit të “Ciganëve” në Gjermani ishin “Zigeunermischlinge”, “Ciganët” e supozuar të “gjakut të përzier” të cilët, sipas teoricienit për higjienën racore Robert Ritter, kishin “devijuar nga natyra e

tyre origjinale biologjike.” Politika vendore nuk kishte në shënjestër grupin e vogël të romëve shëtites, të cilët martoheshin në mes vete dhe klasifikoheshin si “të pastër nga pikëpamja racore”. Mirëpo, në territoret e okupuara nga gjermanët pikërisht politika e kundërt triumfoi pas vitit 1939: romët



III. 2

Një nga format e Robert Ritter për regjistrimin e të dhënave biologjike për romët.

(nga Hancock 2002, f. 44)

4.8.41 i anevays	362 Juden, 41 Jüdinnen, 5 russ. Komm. 14 lit. Kommunisten	422
5.8.41 Kaunas	213 Juden, 66 Jüdinnen	279
7.8.41 Ustka	485 " , 87 " , 1 Litauer, war Leichenfledderer an deutschen Soldaten	571
11.8.41 Ukmerge	620 Juden, 82 Jüdinnen	702
9.8.41 Kaunas-Port	484 " , 50 "	534
11.8.41 i anevays	450 " , 48 " , 1 lit. 1 russ. K. 500	598
13.8.41 Alytus	617 " , 100 " , 1 Verbrecher	719
14.8.41 Jonava	497 " , 55 "	552
15. und 16.8.41 Rokiskis	3200 Juden, Jüdinnen und J.-Kinder, 5 lit. Komm., 1 Pole, 1 Artisan	3207
9. bis 16.8.41 Kaunas	294 Jüdinnen, 4 Judenkinde	298
27.8. bis 14.8.41 Rokiskis	495 Juden, 432 Russen, 56 Litauer (alles aktive Kommunisten)	981
18.8.41 Kaunas-Port IV	698 Juden, 402 Jüdinnen, 1 Polin, 711 Intell.-Juden aus dem Ghetto als "Pressemitte für eine Sabotagehandlung"	1812
19.8.41 Ukmerge	290 Juden, 255 Jüdinnen, 1 lit. 88 Judenkinde, 1 russ. Kommunist	645
22.8.41 Lunenburg	1 russ. Komm., 5 Litauer, dabei war 1 "Räuber, 1 russ. (ardist), 1 alen, 1 Litauer, 1 Lituanerin, 1 Zigeunerkind, 1 Jude, 1 Jüdin, 1 Arbeiter, 2 osteurop. (Czechoslov.) -Berufung in Lunenburg	21
- Gesamt:		16152

III. 3

Një raport i "Einsatzgruppe" që regjistron 16,152 njerëz të vrarë, përfshirë romët.

(nga Kenrick / Puxon 1995, f. 91)

endacak ishin në rrezik më të madh sesa romët e vendosur.

Ky tipar dikotomik i persekutimit të "Ciganëve" buroi nga aspektet e ndryshme të theksuara të përfytyrimit armiqësor të "Cigani Tjetër". Në kuadër të Rajhut besohej se kërcënimi kryesor popullor-racor buron nga "Gypsy Mischlinge", që jetonin pjesërisht ose plotësisht të vendosur në ndonjë vend, të cilët gjoja "degjeneronin" "trupin e popullit gjerman" përmes kontakteve të tyre më intensive shoqërore me shumicën e popullsisë. Jashtë Rajhut, veçanërisht në territoret e okupuara lindore, konstrukti fantazmë i "Cigani Tjetër" u projektua kryesisht ndaj romëve shëtitës. Konsiderohej se mënyra e tyre "mobile" e jetesës thjeshtë maskonte aktivitetet e tyre spiunuese kundër gjermanëve në shërbim të "armikut botëror Çifut -Bolshevik". [III. 2]

NJËSITË MOBILE VRASËSE

Historianët që hetonin politikën e Nacional Socialistëve ndaj romëve pajtohen se ishte Lufta e Dytë Botërore— e

vënë në lëvizje nga regjimi nazist me 1 shtator, 1939, me sulmin e tij ndaj Polonisë— që shpiti në një rritje të pafund të shtypjes dhe persekutimit që përfunduan me gjenocid. Në veçanti, sulmi gjerman ndaj Bashkimit Sovjetik në verë të vitit 1941, që nga fillimi kishte karakterin e luftës raciste të pushtimit dhe asgjësimit. Për këtë fushatë u krijuan katër "Einsatzgruppen" (A, B, C, dhe D), njësi mobile vrasëse të SS. Ata morën udhëzimet e tyre kryesore nga Zyra Kryesore e Rajhut për Siguri. Në përgjithësi, katër task forcat A, B, C dhe D përbëheshin nga 3,000 meshkuj. Ata kishin për detyrë të vrisnin më shumë se një milion njerëz. [III. 1]

"Einsatzgruppen" përdori udhëzime të gjera për përzgjedhjen e shënjestrave për vrasjet e tyre. Përkufizimet precize nuk iu interesonin atyre. Task Forca A, që kreu vrasjet në shtetet baltike dhe pjesët veriore të Rusisë, llogaritën se numri i viktimave të saj deri me 1 shkurt, 1942, ishte 240,410. Së bashku me 218,000 Çifutë të pushkatuar dhe 5,500 tjerë të vrarë në masakër, ata radhitën kategoritë e të vdekurve si "Lituanëz që kalonin kufirin, komunistë,

partizanë, të sëmurë mendor dhe të tjerë". Për përbërjen e 311 "të tjerëve" nuk u dhanë më hollësi. Romët mund të jenë klasifikuar në mesin e "partizanëve" dhe "të tjerëve". [III. 3]

Romët me të vërtetë ishin në mesin e viktimave të "Einsatzgruppen" dhe njësitve tjera SS në tokën sovjetike dhe baltike. Grupi i parë në shënjestrën e tyre kishin qenë Çifutët në shtetin sovjetik dhe burokracinë e partisë komuniste, inteligjenca çifute dhe çdo çifut që konsiderohej i gatshëm të rezistonte. Veç gjatë muajit të parë të fushatës sovjetike, "Einsatzgruppen" radikalizuan veprimet e tyre. Tani ata filluan të vrisnin sa më shumë popullatë çifute që ishte e mundur. Njëkohësisht, vrasja u zgjerua te romët.

Në BRSS dhe shtetet baltike njësitë "Wehrmacht" (ushtarake) gjermane shpesh nuk përfshiheshin drejtpërdrejtë në asgjësimin e romëve. Por Policia Ushtarake, Policia Ushtarake Sekrete dhe në veçanti zona e pasme e ushtrisë "Sicherungsdivisionen" posaçërisht ia dorëzoi "Ciganët shëtitës" njësisë "Einsatzgruppen" për t'i pushkatuar. Përveç kësaj, njësitë "Wehrmacht" ofruan një

IMAZHI I “ARMIKUT”

Aktiviteti i “Einsatzgruppen” dhe njërive tjera SS u bazua në imazhin e artikuluar të armikut në aspektin hierarkik. Në maje ishin Çifutët dhe komunistët dhe paraqitja e tyre iluzioniste në formën e konspiracionit botëror Çifutë-Bolshevik”. Në këtë piramidë ideologjike, “Ciganët” zinin një shkallë vartëse por jo edhe të parëndësishme. Ata figuronin si “inferior nga pikëpamja racore”, “asocial” të qëllimshëm, si “partizanë”, “spiunë”, dhe “agjentë” të “armikut botëror çifut” të imagjinuar. Të shikuar nga “Einsatzgruppen” si informatorët e shtyllës së pestë në shërbim të “Bolshevizmit Çifut”, në shënjestër viheshin posaçërisht romët udhëtues kurdo që njësitë vrasëse mësonin për ekzistencën e tyre. Duke u konsideruar thjeshtë si ndihmës të “armikut botëror”, likuidimi i tyre nuk ishte prioriteti i parë.

III. 4

Die im Lande umherirrenden Zigeuner bilden eine Gefahr in doppelter Hinsicht:

- 1.) als Überträger von ansteckenden Krankheiten, insbesondere von Fleckfieber,
- 2.) als unzuverlässige Elemente, die sich weder den Vorschriften der deutschen Behörden beugen, noch gewillt sind, eine nutzbringende Arbeit zu verrichten.

Es besteht begründeter Verdacht, dass sie durch Nachrichtenübermittlungen im feindlichen Sinne der deutschen Sache Schaden. Ich bestimme daher, dass sie in der Behandlung den Juden gleichgestellt werden.

III. 5

Letra e Hinrich Lohse e dhjetorit të vitit 1941. Në arsytimin e vrasjes e romëve për motive racore në Libau, Lohse përshkroi “Ciganët që bridhnin përreth vendit” si bartës të sëmundjeve infektive, përveç asaj që ishin “elementë të dyshimtë që as nuk i binden urdhrave të autoriteteve gjermane, as nuk dëshirojnë të kryejnë punë të dobishme.” Për më tepër, ai pohon, ishte një dyshim i bazuar që ata dëmtonin kauzën gjermane përmes dhënies së informatave. Duke u etiketuar në këtë mënyrë si spiunë, antisocialistë dhe kërcënim për shëndetin e njerëzve, “Ciganët” u paraqitën nga Lohse si të përshtatshëm për masakër: “Unë deklaroj që ata duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si Çifutët.”

(nga Zimmermann 1999, f. 143) (Detaj)

asistencë të konsiderueshme organizative dhe teknike në kombinim me ekzekutimet e kryera nga “Einsatzgruppen”. “Einsatzgruppen” vranë romët të cilët iu binin në duar, por nuk i kërkonte ata me zellin që kishin për zbulimin e Çifutëve dhe komunistëve. Mirëpo, kur “Einsatzgruppen” mobile u transferuan në njësi statike të Policisë së Sigurisë dhe u plotësua nga njësitë e Policisë Gjermane të Rendit, dhe nuk mund të llogarisnin në përkrahjen e autoriteteve pushtuese civile, sikurse në regjionin e Baltikut, ata vazhduan të vrisnin romët në mënyrë sistematike. [Illa. 4, 5]

LETONIA

Edhe pse deri më tani nuk kemi informata të mjaftueshme për vrasjet e romëve në Lituani, ne dimë saktësisht se në Letoni vrasja sistematike e romëve filloi me 4 dhjetor, 1941, me vrasjen e rreth njëqind romëve nga qytetit Libau. Kryesit ishin anëtarë të divizionit të Policisë Gjermane të Rendit në atë qytet. Kjo vrasje ishte arsye për një iniciativë të Komandantit të Poli-

cisë së Rendit në “Ostland” (që përfshinte shtetet baltike dhe Bjellorusinë) Georg Jedicke. Ai organizoi që Gubernatori i Shtetit “Ostland” Hinrich Lohse të shkruante një letër që sinjalizonte marrëveshjen e tij për vrasjen e “Ciganëve” në Libau. Në këtë letër, Lohse deklaroi që “Ciganët ... që bridhnin përreth vendit ... duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si Çifutët.” [III. 5]

Urdhërsa e Lohses e datës 4 dhjetor, 1941, as nuk kishte përcaktuar se si një person duhej të klasifikohet si “Cigan” as nëse fraza “Ciganët që bridhnin përreth vendit” nënkuptonte gjithashtu romët e vendosur. Policia Gjermane e Sigurisë në Letoni interpretoi deklaratën e guvernatorit të shtetit në kuptimin që “Ciganët e vendosur që kanë punë të rregullt dhe që nuk paraqitnin rrezik për shoqërinë në kuptimin politik ose kriminal” duhej të përjashtoheshin nga arrestimet dhe pushkatimet. Në anën tjetër, kolegët e tyre në Policinë e Rendit të cilët arrestonin romët dhe ua dërgonin Policisë së Sigurisë e morën frazën “Ciganët që bridhnin përreth vendit” të nënkuptonte të gjithë “Ciganët”. Prandaj, në Letoni,

shtet baltik me popullatën më të madhe rome, romët nomadë dhe ata të vendosur iu dërguan Policisë së Sigurisë për pushkatim në muajt e parë të vitit 1942.

Mungesa e qartësisë që mbizotëroi në mes të Policisë së Sigurisë dhe Policisë së Rendit rreth përcaktimit për vrasjen e viktimave shkaktoi që Karl Friedrich Knecht, Komandant i Policisë së Rendit për Letoni, të lëshonte një urdhëresë shpjeguese në mars dhe pastaj edhe në prill të vitit 1942. Sipas kësaj urdhërese, pas diskutimit me komandantin e Policisë së Sigurisë në Letoni, ishte vendosur që në të ardhmen “vetëm Ciganët endacak” duhej të arrestoheshin dhe t’i dorëzoheshin Policisë së Sigurisë. Gjatë viteve 1942 dhe 1943, në tërë Letoninë, romët humbën jetën e tyre si rezultat i kësaj urdhërese të paqartë që nuk krijoi kufij të saktë në mes të “Ciganëve” “endacak” dhe atyre të vendosur dhe kështu i dhanë policisë duart e lira që në muajt e ardhshëm t’i përzgjidhnin viktimat. Përafërsisht gjysma e diku 3,800 romëve në Letoni u vranë. Ata romë që nuk u pushkatuan në Letoni

morën urdhrin që të mos largoheshin nga vendbanimi i tyre.

ESTONIA

Pushkatimet e para të romëve në Estoni ndodhën menjëherë pas pushtimit gjerman në qershor të vitit 1941, me iniciativën estoneze. Në mungesë të një politike koherente anti-“Cigane”, urdhrat kundërthënës lidhur me trajtimin e “Ciganëve” të lëshuara nga Zyra Kryesore e Rajhut për Siguri, Ministria gjermane për territoret e pushtuara lindore, dhe “Wehrmacht”, krijuan një gjendje të çorientimit, që me gjasë ndikuan në mbijetesën e shumicës së romëve estonez gjatë vjeshtës së hershme të vitit 1943. Kah fundi i vitit 1941 – dhe fillimi i 1942, Policia Kriminale Estoneze, që vepronte nën komandën gjermane, filloi t’i ekzaminonte romët. Disa nga ata u dëbuan në kampin e përqendrimit afër Tallinn. Deri në verën e vitit 1942, të gjithë romët në Estoni u nënshtruan punës së detyrueshme. Pushkatimi i parë masiv që mori jetën e një të tretës së popullatës rome të Estonisë ndodhi në tetor të vitit 1942.

Gjatë janarit dhe shkurtit të vitit 1943, romëve të mbetur iu hoq e drejta ndaj pronës së tyre dhe u dërguan në kampin e përqendrimit në Tallinn. Romët e mbetur estonez u pushkatuan në fillim të tetorit të vitit 1943. Disa javë më herët, ushtria sovjetike kishte filluar ofensivën kundër “Wehrmacht” në Rusinë veriore. Derisa trupat sovjetike iu afruan Estonisë së pushtuar nga gjermanët Policia e Sigurisë vrau romët e burgosur në kampin e përqendrimit në Tallinn, duke vepruar nën iluzionin racist që këta romë estonez do të vepronin si një “shtyllë e pestë” e Ushtrisë së Kuqe. Vetëm në mes 5 dhe 10 përqind të 750-850 romëve të fortë të para luftës në Estoni i mbijetuan pushtimit gjerman.

AUSCHWITZ-BIRKENAU

Në fillim të verës së vitit 1942, derisa Ministria gjermane e territoreve të pushtuara lindore filloi t’i konsideronte politikën “Cigane”, arrestimet dhe pushkatimet masive nga Policia gjermane e Sigurisë veç ishin në nivelin

më të lartë. Diskutimi për urdhëresën e propozuar, “Trajtimi i Ciganëve në territoret e okupuara lindore”, vazhdoi në Ministrinë për Lindje deri në fillim të vitit 1943. Tani ishte propozuar që të gjithë “Ciganët” të mblidheshin dhe të vendoseshin nën kontroll në kampet dhe vendbanimet speciale, natyra e të cilave nuk u përcaktua. Heinrich Himmler, si udhëheqës i SS, refuzoi propozimin e Ministrisë së Lindjes. Tani ai ishte i mendimit që “Ciganët” e vendosur duhej të trajtoheshin si banorët e tjerë ndërsa të gjithë “Ciganët endacak” duhej t’i nënshtroheshin rregullave të njëjta sikurse Çifutët. Derisa në vitin 1942 ata të etiketuar si “Ciganë endacak” ishin pushkatuar, tani, në vitin 1943, u propozua që ata duhej të dërgoheshin në kampet e përqendrimit. Kjo ishte, në gjuhën e fshehur, një urdhër për përqendrimin e romëve shëtitës të Evropës lindore në Auschwitz-Birkenau ku SS kishin ngritur një seksion special “Cigan” në fillim të vitit 1943. Në vitin 1944, 2,000-3,000 romë u dëbuan në Auschwitz prej Brest-Litovsk, që i përkiste Bjellorusisë së okupuar nga gjermanët, dhe prej Lituaniës.

PËRFUNDIM

Është vështirë e mundshme të llogaritet me saktësi numri i romëve lituan, leton, dhe estonez të vranë në Shtetet

baltike dhe në Auschwitz-Birkenau. Në Letoni “Einsatzgruppe” mobile A dhe njësitë policore statike vranë rreth gjysmën e 3,800 romëve. Në Estoni në mes 90 dhe 95 përqind të 750-850

romëve që jetonin atje u vranë. Rasti i Lituaniës ka nevojë për më tepër kërkim, por historianët vlerësojnë se shumica dërmuese e romëve që jetonin atje u vranë.

Bibliografia

Hancock, Ian (2002) *We are the Romani people. A me sam e Rromane džene*. Hatfield: University of Hertfordshire Press | **Kenrick, Donald / Puxon, Grattan (1995)** *Gypsies under the Swastika*. Hatfield: University of Hertfordshire Press | **Weiss-Wendt, Anton (2003)** *Extermination of the Gypsies in Estonia during World War II - Popular Images and Official Policies*. In: *Holocaust and Genocide Studies*, Vol. 17, pp. 31-61 | **Zimmermann, Michael (1999)** *The Soviet Union and the Baltic States 1941-44: the massacre of the Gypsies*. In: *Kenrick, Donald (ed.) In the shadow of the Swastika. The Gypsies during the Second World War - 2*. Hatfield: University of Hertfordshire Press, pp. 131-148 | **Zimmermann, Michael (2001)** *The Wehrmacht and the National Socialist Persecution of the Gypsies*. In: *Romani Studies 5*, Vol. 11, No. 2, pp. 111-135

